2020

RAPORTI VJETOR
I KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EUROPIAN

RAPORT VJETOR_2020

PËRMBAJTJA:

I. MISIONI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EUROPIAN

II. MONITORIMI I ZBATIMIT TË DETYRIMEVE TË PROCESIT TË INTEGRIMIT

III. RRITJA DHE FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE PËR ÇËSHTJET E INTEGRIMIT EUROPIAN

IV. SHOQËRIA CIVILE NË KËSHILLIN KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

VI. ANEKSE

I. MISIONI I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE), është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin europian, e krijuar në bazë të Ligjit nr. 15/2015, datë 05.03.2015, "*Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian*"[1], si një instrument i rëndësishëm për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse lidhur me reformat integruese të vendit.

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian misionin e tij parësor ka nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe sigurimin e rritjes së transparencës në vendimmarrjet për çështjet e integrimit.

Krijimi i Këshillit Kombëtar u iniciua në adresim të rekomandimit të Dialogut të Nivelit të Lartë BE-Shqipëri, për ngritjen e një strukture gjithëpërfshirëse për integrimin europian, e cila do të garantonte zhvillimin e një dialogu politik konstruktiv e të qëndrueshëm dhe do të siguronte gjithpërfshirjen në realizimin e reformave dhe detyrimeve të anëtarësimit[2]. Kjo strukturë ka forcuar më tej rolin kontrollues të Kuvendit në procesin e integrimit europian, duke mundësuar fuqizimin e vazhdueshëm të rolit të tij, si një aktor i rëndësishëm në monitorimin e detyrimeve të anëtarësimit.

Përgjegjësitë kryesore të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian janë:

- nxitja e bashkëpunimit midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura dhe shoqërisë civile, në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian;

[1] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji_15-2015-1.pdf
[2] Konkluzionet e takimit të parë të Dialogut të Nivelit të Lartë BE-Shqipëri.

- sigurimi i një diskutimi të vazhdueshëm për politikat e integrimit europian, të zbatuara nga institucionet shtetërore, me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar;
- monitorimi i zbatimit të detyrimeve për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian;
- analizimi i kuadrit ekzistues normativ dhe praktikave në lidhje me procesin e integrimit europian, për çështjet që merr në shqyrtim; sigurimi i bashkëpunit të vazhdueshëm për procesin e integrimit me komisionet e përhershme parlamentare dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për integrimin europian; monitorimi i ecurisë së procesit të negociatave/bisedimeve për anëtarësim;
- këshillon ose jep opinione lidhur me procesin e negociatave;
- mban kontakte dhe shkëmben informacion me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Kombëtar për Integrim Europian;
- zhvillon takime me drejtuesit e grupit negociator dhe drejtuesin e delegacionit shqiptar në negociatat/bisedimet për anëtarësim;
- raporton të paktën një herë në vit në Kuvend mbi punën e Këshillit.

Në zbatim të rolit të tij, si një garantues i dialogut gjithpërfshirës, KKIE ka pasur në fokus, promovimin e përfshirjes të të gjithë aktorëve të procesit të integrimit europian. Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian e sheh parësor rolin e shoqërisë civile dhe të gjithë aktorëve të procesit të integrimit, ndaj do të vijojë të forcojë në mënyrë të vazhdueshme bashkëpunimin me shoqërinë civile si dhe të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të saj, si një partner shumë i rëndësishëm në ecurinë e suksesshme të reformave të integrimit.

II. MONITORIMI I ZBATIMIT TË DETYRIMEVE TË PROCESIT TË INTEGRIMIT

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian, bazuar në misionin e tij gjithëpërfshirës si dhe në përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në Bashkimin Europian i ka kushtuar vëmendje të veçantë rolit të rëndësishëm që luan në drejtim të garantimit të bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet forcave politike dhe institucioneve publike, por veçanërisht bashkëpunimit me shoqërinë civile, botën akademike dhe të gjitha grupet e interesit të shoqërisë.

Referuar rekomandimeve të dhëna në Raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2019[3] dhe 2020[4], forcimi dhe rritja e kapaciteteve mbikqyrëse të Kuvendit, si dhe gjithëpërfshirja në procesin e integrimit të Shqipërisë në familjen europiane, janë udhërrëfyesi i punës së Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian.

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës si dhe sfidat integruese të vendit, KKIE i ka kushtuar veçanërisht vëmendje reformës në drejtësi dhe dakortësisë në reformën zgjedhore, nxitjes së dialogut konstruktiv dhe gjithëpërfshirës deri në nivele të larta në lidhje me detyrimet e BE deri në mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare, përmirësimit të njohurive mbi procesin e integrimit europian të të gjithë grupeve të interesit, transparencës si domosdoshmëri integruese, dhe nxitjes së një dialogu konstruktiv të nevojshëm mbi prioritetet dhe detyrimet e shtuara në fazën aktuale pandemike.

Këshillit Kombëtar i Integrimit Europian bazuar edhe në Planin e tij të Punës për vitin 2020, ka organizuar në total 5 takime periodike dhe 3 takime ndërgjegjësuese. Më poshtë jepet një informacion i përmbledhur mbi tematikat e diskutuara:

[3] Rekomandimet mund të konsultohen në linkun: https://www.parlament.al/Files/Kerkese/20190708131532Mbi%20gjetjet%20dhe%20rekomandimet%20e%20Raportit%20te%20Komisionit%20Evropian%20per%20Shqiperine%202019.pdf
[4] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/plani%20i%20veprimit%20FINAL.pdf

- ***ZBATIMI I STRATEGJISË SË MIGRACIONIT-MASAT PËR KUFIZIMIN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT***

Bazuar në rekomandimin e përsëritur të Komisionit Europian mbi migracionin, si një fenomen që impakton shoqërinë shqiptare, KKIE në takimin e tij të parë për vitin 2020, i cili u mbajt në 24.01.2020[5], diskutoi gjërësisht mbi zbatimin e strategjisë së migracionit, me fokus masat e marra nga qeveria për kufizimin e migracionit të parregullt të shtetasve shqipëtarë drejt vendeve të BE-së duke përfshirë politikat e punësimit, mbrojtjen sociale për personat e rikthyer, politikat arsimore të ndjekura, etj. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian (KKIE) u informuan për sa më sipër nga Zëvendësministria e Brendshme; përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë; Zëvendësministria e Financave dhe Ekonomisë; Zëvendësministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, si dhe drejtuesja e seksionit për Shtetin e së Drejtës dhe Mirëqeverisjes në Delegacionin e BE-së në Tiranë. Mbi impaktin e largimit të punëtorëve të kualifikuar nga vendi anëtarët e KKIE u informuan nga Kryetari i Konfederatës së Sindikatave dhe Këshilltari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë. Ndërsa lidhur me projektet në fushën e migracionit dhe propozime për parandalimin e largimit të punëtorëve të kualifikuar si dhe integrimin e personave të kthyer, referuan drejtuesja e zyrës së IOM dhe përfaqësuesi i GIZ Albania.

[5] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Procesverbal.pdf

Gjatë këtij takimi u prezantua, diskutua dhe miratua nga anëtarët e KKIE dhe Raporti Vjetor i KKIE për vitin 2019 si dhe planifikimi i aktiviteteve për vitin 2020.

- ***ECURIA NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË KOMISIONIT EUROPIAN 2019 PËR SHQIPËRINË SI DHE NËNKOMITETIN BE-SHQIPËRI PËR DREJTËSI, LIRI DHE SIGURI 2019.***

Procesi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian (BE) është konsideruar si prioriteti më strategjik kombëtar, i cili udhëheq axhendën qeverisëse të vendit dhe në realizimin e tij është e

domosdoshme përmbushja e pesë prioriteteve themelore. Fenomeni i korrupsionit ngadalëson dhe vështirëson proceset integruese të vendit. Nevoja për një shoqëri të re, që ngrihet mbi vlerat e qasjes anti-korrupsion e që mbështetet nga institucione të forta, që veprojnë përmes integritetit dhe transparencës, janë vlerësuar si prioritare nga KKIE. Ndaj në 04.02.2020[6], në bashkëpunim me Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC Albania) në kuadër të Javës së Integritetit, është organizuar takimi ndërgjegjësues mbi ecurinë e luftës kundër korrupsionit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Europian në Raportin e vitit 2019 për Shqipërinë, si dhe Nënkomitetin BE- Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2019. Në takim u konsiderua si një mesazh inkurajues për qytetarët përfshirja e aktorëve politikë, shoqërisë civile dhe qytetarëve në përpjekjet e përbashkëta anti-korrupsion duke denoncuar praktikat korruptive. Ministrja e Drejtësisë dhe Ministrja e Ekonomisë dhe Financave, të ftuara në këtë takim, vlerësuan mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë: Zyra e Delegacionit të BE-së në Shqipëri dhe Ambasada e Holandës në këtë javë ndërgjegjësimi. Gjithashtu u shpreh se janë parë me prioritet rekomandimet e ardhura nga Komisioni Europian dhe Bundestag-u gjerman duke u përkthyer si një seri masash dhe rregullimesh legjislative që shkojnë drejt natyrës parandaluese, represive dhe ndërgjegjësuese duke potencuar rëndësinë e gjithpërfshirjes. Një masë që e shpie qasjen korruptive drejt reduktimit, ajo e vuri theksin te objektivi për digjitalizimin e sa më shumë shërbimeve publike, çka përveçse përfshin teknologjinë në proces, rrit edhe vetë transparencën e tyre duke ulur praktikat korruptive.

[6] https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=7

Lidhur me çështjet që lidhen me biznesin dhe kuadrin juridik, Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, theksoi se përmirësimi i vazhdueshëm i klimës së biznesit lidhet me shumë prej proceseve legjislative, që kanë nisur prej kohësh në shumë sektorë strategjikë, që prekin ekonominë, duke theksuar fokusin që i duhet vënë raportimit financiar të shëndetshëm dhe transparent në çdo biznesi, qoftë ky vendas apo i huaj, në vendosjen e një konkurrence të ndershme, krijimin e aksesit në financim, lëvizshmëri kapitali dhe në rritje ekonomike të vendit. Përmes përshtatshmërisë së ligjeve me "acquis e BE-së, po ecet drejt zvogëlimit të qasjeve korruptive, (nismat e paketës ligjore "Moneyval") dhe procesin e fiskalizimit si dhe objektiv institucional digjitalizimin e shërbimeve, si siguri për një tjetër hap në reduktimin e praktikave korruptive. Ligji i kontabilitetit, që vjen me asistencën e Bankës Botërore dhe SECO-s, është një tjetër hap konkret drejt luftës anti-korrupsion. U theksua rëndësia e denoncimeve dhe

përfshirjes së publikut në procesin e konsultimeve publike p.sh ligji fiskalizimit, në të cilin 4 nene erdhën si propozime ndryshimesh nga vetë aktorët publikë dhe shoqërorë.

❖ *MBLEDHJE E ZGJERUAR E KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EUROPIAN*

Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian i ka kushtuar një rëndësi të madhe përgatitjes për negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Rritja e dialogut ndërinstitucional deri në nivele të larta kur shtrohen çështjet e integrimit, rrahja e mendimeve dhe veprimeve të dakortësuara me të gjithë aktorët, i shërben edhe organizimi i takimit të zgjeruar në 9 Qershor 2020, të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian me përfaqësuesit më të lartë shtetërorë si Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryenegociatori, Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Europian, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, drejtues të institucioneve të pavarura si dhe ambasadorët e përfaqësuesit më të lartë të vendeve anëtare të BE[7].

"Zhvillimet më të fundit në kuadër të përgatitjeve për procesin e negociatave në Bashkimin Europian dhe prezantimi i projekt-planit gjithëpërfshirës të Masave të Integrimit Evropian nga Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme" ishin thelbi i diskutimit të zgjeruar me përfaqësuesit më të lartë të shtetit. *Kryetarja e KKIE* theksoi se përtej hapave që do të duhet të ndjekim si shtet, përtej hapjes së negociatave, përtej kapitujve të integrimit, përtej përshtatjes së legjislacionit, prioritet, së pari, është ndryshimi i sistemit të vlerave. Shqipëria i ka të gjitha mundësitë dhe thjesht ka nevojë për një klasë politike, e cila i përgjigjet me ndershmëri. *Presidenti i Republikës* vlerësoi përkushtimin dhe mbështetjen e institucioneve europiane kundrejtë integrimit europian të Shqipërisë si dhe nënvizoi domosdoshmërinë e një plan-veprimi të përpiluar nga qeveria, ku analizohen kushtet e vendosura nga

7 https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Procesverbal%20takimi%20KKIE,%20dat%C3%AB%20%2009.06%202020.pdf

BE, aktorët përgjegjës, termat konkrete e të matshëm të veprimit, e po ashtu kostot për secilin veprim. *Kryeministri* theksoi nevojën për bashkëpunim të aktorëve kombëtarë në aspektin e kuadrit negociator, dhe në veçanti të reformës zgjedhore. *Kryetari i Kuvendit* vuri në dukje rëndësinë e dakortësimit të Këshillit Politik për reformën zgjedhore, duke theksuar rolin kyç të Kuvendit në zbatimin e reformës në drejtësi. Funksioni mbikqyrës i Kuvendit u nënvizua si element kritik në mbështetjen e Qeverisë për të arritur konsensusin e gjëre politik në vend. Dy sygjerimet e Kuvendit kundrejt Planit të Masave të Integrimit Europian janë parashikimi specifik në plan-veprim të çdo prioriteti, dhe lidhja e çdo mase me institucionin përgjegjës, afatet e faturën përkatëse. *Nënkryetari i KKIE,* duke diskutuar rëndësinë që rajoni i Ballkanit Perëndimor ka kundrejt Bashkimit Europian, tregoi mirënjohjen e thellë të shumicës parlamentare ndaj mobilizimit të BE, paketës financiare dhe solidaritetit të BE për Shqipërinë. *Përfaqësuesi i BE-së i delegacionit europian* në Shqipëri theksoi se Bashkimi Europian është i gatshëm të ndërmarrë hapa avancues në diskutimet europiane për Shqipërinë. Procesi i kuadrit negociues pritet të shqyrtohet nga shtetet anëtare dhe më pas të miratohet në Këshillin Europian. Kësaj gatishmërie duhet t'i përgjigjet një shoqëri shqiptare e aftë për të finalizuar hapat e fundit para Konferencës së Parë Ndërqeveritare. Për më tepër, fryma e bashkëpunimit është e domosdoshme në mënyrë që rezultatet e përpjekjes europiane të jenë të plota dhe gjithëpërfshirëse.

Pjesë e takimit me diskutimet dhe sygjerimet e tyre u bënë edhe nga Avokati i Popullit, Kryetari i IDM, Kryenegociatori, dhe Kryetar i KED. *Avokati i Popullit* nënvizoi domosdoshmërinë e përfaqësimit të lartë të institucioneve gjatë hartimit të plan-veprimit për masat e integrimit europian. *Drejtori Ekzektuiv i IDM* kërkoi përfshirjen e shoqërisë civile. Kryenegociatorit theksoi përsëri nevojën për bashkëpunim të aktorëve përkatës në realizimin e objektivit europian të Shqipërisë.

- ***PROGRESI DHE SFIDAT NË KUADËR TË KRITERIT POLITIK, KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT E NJERIUT***

Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, zhvilloi online në datën 23.09.2020, takimin për progresin e realizuar dhe sfidat në kuadër të kriterit politik dhe kapitullit 23 'Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut", me fokusin në 15 pikat e vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 mars 2020 për hapjen

e negociatave[8]. Për të informuar anëtarët dhe të ftuarit e KKIE-së lidhur me progresin e bërë në kuadër të kapitullit 23 dhe sfidat e së ardhmes ishte e ftuar Ministrja e Drejtësisë. Kryetarja e KKIE ngriti shqetësimin e përkeqësimit të fenomenit të korrupsionit dhe të pastrimit të parave duke cituar indeksin e perceptimit të korrupsionit sipas "Transparency International". Kryetarja e KKIE theksoi si të rëndësishme moszvarritjen e procedurave nga institucionet e pavarura, në mënyrë që të krijohet kuorumi i nevojshëm në Gjykatë të Lartë për tu hapur rruga në plotësimin e vakancave në Gjykatë Kushtetuese. U theksua gjithashtu domosdoshmëria e angazhimit të të gjitha forcave politike, të qeverisë dhe institucioneve të pavarura kushtetuese edhe ato të krijuara me ligj, pushtetit lokal dhe shoqërisë civile, në përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit. Nënkryetari i KKIE-së, i konsideroi Kapitujt 23 dhe 24 të rëndësishëm për të përcaktuar përparimin e vendit në rrugëtimin europian krahasueshmërisht me vendet e tjera, duke shprehur domosdoshmërinë e shtimit të llogaridhënies së institucioneve përpara KKIE, por pa e anashkaluar edhe funksionin monitorues e kontrollues të Kuvendit, duke theksuar se Kuvendi ka rol të pazëvendësueshëm në monitorim të aktivitetit të strukturave shtetërore në përmbushjen e detyrimeve të procesit të integrimit europian, dhe shërben si urë lidhëse mes aktorëve të përfshirë në proces. Anëtarët e KKIE u njohën edhe me sfidat si dhe vështirësitë e hasura në plotësimin e strukturave të institucioneve të reja të drejtësisë. Shtimi i përpjekjeve në disa drejtime: reforma në drejtësi, luftën kundër korrupsionit, parandalimi i pastrimit të parave, u theksuan nga *Ministrja e Drejtësisë*, duke u ndalur më gjerësisht në funksionalitetin e plotë të KLGJ dhe KLP, ngritjen e SPAK-ut në dhjetor 2019, emërimin e drejtorit të BKH-së, emërimin e tre gjyqtarëve në Gjykatën të Lartë si dhe emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Ndërsa Nënkryetarja e Kuvendit shtoi edhe përpjekjet e Kuvendit për të nxitur zgjidhjen e problemeve të vërejtura në procesin e punës së Gjykatës Kushtetuese siç ishte edhe ngritja e një grupi pune në komisionin e ligjeve për të shqyrtuar të gjitha dekretet. Gjithashtu u nënvizua reagimi pozitiv që Kuvendi ka marrë nga raportet e ndërkombëtarëve në qasjen që ai ka ndaj transparencës dhe procesit të konsultimit

[8] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Precesverbal23.09.2020.pdf

publik. Pjesë aktive e diskutimeve u bënë edhe Avokati i Popullit; Këshilltari i Presidentit të Republikës dhe Drejtuesja Ekzekutive e Komiteti i Helsinkit.

- ***PREZANTIMI I RAPORTI VJETOR TË KOMISIONI EUROPIAN PËR SHQIPËRINË***

Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, në takimin e datës 8 Tetor 2020, u njoh me Raportin e përgatitur nga Komisioni Europian Progresit të Shqipërisë për vitin 2020, dhe prezantuar nga

Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri[9]. Ambasadori i Delegacionit të BE-së prezantoi paketën e zgjerimit, raportin vjetor të Komisionit dhe u ndal edhe tek plani i investimeve ekonomike, duke theksuar ndryshimet e reja të metodologjisë që e bëjnë raportin më rigoroz në vlerësim pas përfshirjes së shteteve anëtare në hartimin e tij.

U theksua nevoja e përmirësimit të dialogut politik si dhe plotësimi i vendeve vakante në Gjykatë Kushtetuese. Lidhur me luftën kundër korrupsionit ai u shpreh se duhet punuar që të forcohet bilanci i

[9]https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Procesverbal%20i%20takimit%20t%C3%AB%20KKIE,%20dat%C3%AB%2008.10.2020%20.pdf

hetimit, ndjekjes penale dhe dënimeve. Korrupsionin e cilësoi një shqetësim serioz dhe tregoi vlerësim për numrin në rritje të operacioneve të përbashkëta mes Shqipërisë dhe vendeve partnere në ekipe të përbashkëta hetimore. Ambasadori u shpreh se priteshin hapa të mëtejshme në drejtim të luftës ndaj pastrimit të parave, vuri theks te digjitalizimi, si formë për të ndërprerë lidhjet mes korrupsionit potencial dhe zyrtarëve dhe shtoi se në kuadër të integrimit duhej fuqizuar administrata. Duhet të shtoheshin përpjekjet për të drejtën e pronës dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të pronarëve. Si të vetmen fushë pa progres, ambasadori veçoi lirinë e shprehjes. Një vlerësim të veçantë ambasadori dha për politikën e jashtme, ku vuri theksin te përputhshmëria 100% e politikës së jashtme të Shqipërisë me atë të Bashkimit Evropian. Ai u ndal edhe te plani i investimeve, duke e konsideruar mundësi unike për Shqipërinë dhe të gjithë rajonin, për të përmirësuar integrimin ekonomik rajonal përmes projekteve rajonale dhe shprehu gatishmërinë e BE për mbështetje në tejkalimin e krizes.

Kryetarja e KKIE falënderoi ndihmën e BE-së përmes programit "Tirana Connectivity Forum 2020", që përmes fondeve IPA siguron 70 milionë euro mbështetje në fusha si shëndetësia, punësimi, rinia, qasjet novatore etj., për të ndihmuar ndërlidhjen e rajonit si dhe theksoi paketën e investimeve ekonomike, që Komisioneri Europian për Zgjerimin pati prezantuar në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë. Nënkryetari i KKIE-së e konsideroi mesazh të qartë vlerësimi që i bëhej nga ana e Komisionit Europian ecurisë së Shqipërisë drejt arritjes në mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare dhe nënvizoi përparimet në të gjitha kapitujt që Shqipëria duhet të negociojë gjë që vlerëson edhe Raporti, duke shtuar që po të mbahej parasysh konteksti i këtyre arritjeve, periudha pandemike dhe post-tërmeti, si edhe implikimet socio-ekonomike të të dy këtyre zhvillimeve, arritjet e qeverisë shqiptare marrin vlerë disafishe.

Nënkryetari i KKIE u shpreh i bindur se Shqipëria ka më tepër njohuri e vjen më e gatshme sot, 6 vjet më pas marrjes së statusit, për të mbajtur Konferencën e Parë Ndërqeveritare dhe u ndal te Plani i

Investimeve të BE-së, që shoqëronte paketën e zgjerimit duke e konsideruar këtë plan, një "plan Marshall të procesit të zgjerimit". Zëvendëskryetarja e Kuvendit shprehu zotimin institucional se në zbatim të rekomandimeve të Komisionit Europian për Kuvendin, do të hartohet dhe miratohet një plan veprimi me masat e Kuvendit për përmirësimet e nevojshme ligjore, e shoqëruar me forcimin e kontrollit parlamentar.

- ***PROGRESI DHE SFIDAT E KAPITULLIT 24 ME FOKUS NË 15 PIKAT PËR HAPJEN E NEGOCIATAVE.***

"Progresi i realizuar dhe sfidat në kuadër të Kapitullit 24, me fokusin në 15 pikat e Vendimit të Këshillit të Bashkimit Europian të datës 25 Mars 2020 për hapjen e negociatave dhe Raportin e Komisionit Europian (Tetor 2020)" ishte tema e diskutuar në takimin on line të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian të datës 3 Nëntor 2020[10]. Takimi përcolli mesazhin se Shqipëria vazhdon të jetë fuqimisht e ankoruar në projektin historik të integrimit në familjen europaine. Kjo vendosmëri, e shoqëruar me një vetëdije të fortë në lidhje me sfidat që na presin, duhet të shprehë gatishmërinë për përmbushjen e tyre nga secili sipas sektorëve që mbulon dhe adresimin e tyre me përgjegjshmëri duke rritur transparencën dhe llogaridhënien nga institucionet përgjrgjëse. Analizimi i progresit të arritur në kapitullin 24, që ka të bëjë me drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, u detajuan nga Ministri i Brendshëm, i cili informoi KKIE, në detaje me realizimet dhe përparësitë në lidhje me të gjitha kërkesat e kapitullit 24. *Prokurori i Përgjithshëm i*nformoi KKIE mbi bashkëpunimin e frytshëm prokurori-polici e shtetit dhe një këndvështrim i ri i mënyrës së bashkëveprimit dhe operimit në kuadrin institucional të afrimit të prioriteteve në ndërtimin e strategjive afatgjata të nevojshme për t'u përballur institucionet me krimin.

[10] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Keshilli%20kombetar%20i%20integrimit%203%2011%202020.pdf

Gjithashtu mbështeti bashkëpunimin e frytshëm mes Ministrisë së Financave (tatime e dogana) në hetimin për krimin financiar, pastrimin e parave, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve.Takimi i Këshillit Kombëtar potencoi nevojën e rritjes së efektivitetit nga institucionet përgjegjëse në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat janë pjesë e kapitulli 24, si dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërinstitucional.

- **Gjatë vitit 2020, Sekretarati Teknik i KKIE në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile organizoi dy takime ndërgjegjësuese**:

- në datën 26 shkurt 2020 [11]u zhvillua një forum informues në qytetin e Shkodrës me qëllim informimin e qytetarëve, punonjësve të pushtetit lokal dhe studentëve e pedagogeve të Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës, mbi rolin e Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian, rolin e Kuvendit në procesin e Integrimit Europian si dhe mbi progresin dhe problematikat e raportuara pranë KKIE mbi luftën kundër Korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar, reformën në sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut. Gjatë takimit pati diskutime lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe raporteve të Këshillit të Europës dhe ndikimit të tyre në procesin e integrimit europian. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Qendrën ALTRI, në kuadër të iniciativës "Informimi i qytetarëve për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, rruga drejt integrimit të suksesshëm", në qytetin e Shkodrës" mbështetur nga AMShC.

- Në datën 9 dhjetor 2020, [12]Kuvendi i Shqipërisë dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian (KKIE) dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), në partneritet me Slovak Foreign Policy Association, me mbështetjen financiare të SlovakAid, zhvilluan takimin ndërgjegjësues me temë "Siguria ushqimore dhe standardet e kërkuara në kuadër të integrimit europian për Shqipërinë". Në këtë takim u diskutua për sigurinë ushqimore në Shqipëri, sfidat për arritjen e standardeve dhe politikat e ndërmarra, si dhe nevojën për bashkëpunim mes aktorëve shtetërore dhe atyre joshtetërorë në këtë fushë. Nënkryetarja e Kuvendit, njëkohësisht dhe anëtare e KKIE diskutoi mbi rolin e Kuvendit në fushën e sigurisë ushqimore. Ajo u shpreh

[11] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/takim.pdf
[12] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Takimndergjegjsuesdat9Dhjetormbisigurineushqimore.pdf

se pesë ishin fushat e rëndësishme të bashkëpunimit të mundshëm mes Kuvendit dhe shoqërisë civile e ku, si për sigurinë ushqimore, edhe për çështje të tjera, ishte e mirëpritur prania ndihmëse dhe bashkëpunuese e shoqërisë civile: përafrimi i legjislacionit vendas me standarde, forcimi i mbikëqyrjes parlamentare, promovimi i procesit te integrimit evropian nëpërmjet bashkëpunimit parlamentar dhe informimit te publikut, marrja e mendimit të grupeve të interesit në procesin ligjvënës dhe në kontroll parlamentar dhe në drejtim të buxhetimit. Në këtë takim Z. Matej Struhar, eksperti sllovak mbi sigurinë ushqimore, në fjalën e tij solli përvojën sllovake në këtë drejtim, ngjashmëritë dhe mësimet që mund të nxirreshin prej saj. Në përfundim të fjalëve të ekspertëve, të pranishmit në tryezë shtruan pyetje dhe diskutime në lidhje me çështjet si dhe u dhanë rekomandime mbi mangësitë ligjore apo problemet me legjislacionin dhe autoritetet rregullatore, rolit e kapaciteteve të tyre, të cilat i janë përcjellë zyrtarisht Kuvendit si dhe institucioneve përgjegjëse.

III. RRITJA E KAPACITETEVE PËR ÇËSHTJET E INTEGRIMIT EUROPIAN

Këshilli Kombëtar të Integrimit Europian është i vetëdijshëm që sfida e integrimit europian e vendit është sfidë e gjithë shoqërisë dhe kërkon profesionistë të aftë për t'u ballafaquar me procesin jo pak të vështirë të negociatave të anëtarësimit, dhe realizimin e këtij objektivi madhor të vendit tonë, i cili bëhet edhe më i vështirë në kushtet aktuale që po kalon shoqëria shqiptare, por edhe e gjithë bota. Mbështetja e shoqërisë dhe gjithëpërfshirja në realizimin e reformave që përgatisin vendin për anëtarësim në Bashkimin Europian, mund të realizohet në mënyrë të suksesshme vetëm nëpërmjet rritjes dhe fuqizimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të të gjithë grupeve të interesit gjë që është mbështetur vazhdimisht edhe nga Kuvendi i Shqipërisë.

Tradita e suksesshme, e krijuar ndër vite nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian, për të forcuar më tej kapacitetet administrative në çështjet e integrimit në kuadër të përgatitjes për negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, ka vazhduar edhe këtë vit të vështirë të 2020-s. Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian, në partneritet me Delegacionin e Bashkimit Evropian, Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Fondacionin Friedrich Ebert, ka organizuar Shkollën e Integrimit Europian nga data 2-13 Nëntor. Konsolidimi i vazhdueshëm i Shkollës së Integrimit Europian, me synimin për të shtuar kapacitetet vendore në procesin e gjatë e shumëdimensional të integrimit, këtë vit vjen me risinë e zhvillimit të saj on line për shkak të masave Anti Covid-19. Vlen të theksohet se vendimi për shtyrjen e hapjes së negociatave për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Europian si dhe efektet e pandemisë Covid 19 nuk e zbehën aspak interesin e aplikantëve për pjesëmarrje. Komisioni u përball me një numër të madh aplikimesh (217), i cili duke u bazuar në një përzgjedhje transparente dhe duke marrë parasysh përfaqësimin e të gjitha grupeve të

interesit dhe aktorëve të procesit të integrimit, përzgjodhi 37 pjesëmarrës[13], të cilët u bënë pjesë e Shkollës së Integrimit Europian 2020[14]. Ajo u ndoq nga përfaqësues të administratës publike, qeverisjes vendore, organizatave e shoqërisë civile, biznesit dhe medias, akademisë, dhomat kombëtare të avokatisë dhe noterëve. Ndër vite janë trajnuar mbi 186 përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit, të cilët janë kontribues potencialë në procesin e integrimit europian të vendit.



[13] 10 përfaqësues nga qeverisja qendrore dhe institucionet e varësisë,
- 4 përfaqësues nga bashkitë,
- 5 përfaqësues nga akademia,
- 2 kërkues shkencorë
- 4 përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse
- 2 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Avokacisë dhe Noterëve
- 1 përfaqësues nga biznesi
- 2 përfaqësues nga media,
- 5 pjesëmarrës nga Parlamenti.

[14] https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=13

Objektivi kryesor për Shkollën e Integrimit Europian 2020 ishte forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të të gjithë aktorëve, mbi obligimet dhe sfidat e anëtarësimit në BE si dhe zgjerimin dhe forcimin e rrjetit të përfaqësuesve të trajnuar të administratës publike, medias, akademise, biznesit dhe shoqërisë civile, që do të kontribuojnë në procesin e integrimit europian. Në përmbushje edhe të këtij qëllimi axhenda e Shkollës së Integrimit Europian 2020, u konceptua për të mundësuar një trajnim të plotë mbi të gjitha aspektet e negociatave të anëtarësimit dhe sfidat në rritje të këtij procesi[15]. Programi i Shkollës së Integrimit Europian 2020, përfshinte pesë module kryesore:

1. Perspektivat e pranimit në BE, sfidat dhe strategjitë e negocimit (rasti i Serbisë dhe Malit të Zi)
2. Advokatia, roli i shoqërisë civile gjatë procesit të negociatave dhe përafrimi i legjislacionit të BE-së;
3. Zgjerimi i BE-së dhe roli i medias në procesin e integrimit europian;
4. Financimet e BE-së, zhvillimi i projektit dhe negocimi i kapitullit 22;
5. Integrimi në BE dhe bashkëpunimi rajonal / Ballkani Perëndimor / Procesi Berlinit si dhe roli i gjyësorit në zbatimin e legjislacionit europian.

IV. SHOQËRIA CIVILE NË KËSHILLIN KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE) është një mekanizëm institucional i konsultimit të çështjeve të integrimit europian me të gjithë aktorët e interesuar, në të cilin shoqëria civile luan një rol

[15] Informacioni i plotë mbi pjesëmarësit, lektorët dhe axhendën e Shkollës Europiane 2020 mund të gjendet në linkun: https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=13

të rëndësishëm. KKIE është i angazhuar që përfshirja e shoqërisë civile të vijë duke u forcuar nëpërmjet diskutimit të vazhdueshëm për politikat e zbatuara, të cilat lidhen me detyrimet e anëtarësimit. Duke qenë para proceseve të rëndësishme të integrimit në Bashkimin Europian dhe bazuar në rolin gjithëpërfshirës të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian, në vitin 2019 u pa e domosdoshme rritja e numrit të anëtarëve pjesëmarrës të shoqërisë civile në KKIE, të cilët do të japin ekspertizën e tyre sipas kapitujve të veçantë të legjislacionit Europian. Lista e përfaqësuesve të OSHC-ve, anëtarë të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian, është e publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit[16].

Gjatë vitit 2020, Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian duke vlerësuar ekspertizën dhe kontributin e Organizatave të Shoqërisë Civile në çështjet e integrimit europian organizoi në bashkëpunim me OSHC, dy aktivitete ndërgjegjësuese (lutem referojuni informacionit të dhënë në faqen 18-19 të këtij raporti).

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian, veç forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile, ka në fokus të punës së tij edhe rritjen në mënyrë të vazhdueshme të kapaciteteve të saj, si një nga partnerët më të rëndësishëm në ecurinë e suksesshme të reformave të integrimit. Për këtë qëllim gjatë zhvillimit të *pesë raundeve të deritanishme të Shkollës së Integrimit Europian*, i është kushtuar rëndësi e veçantë përzgjedhjes së aplikantëve të spikatur nga shoqëria civile dhe akademike, duke trajnuar në total *50 përfaqësues* nga organizatat e shoqërisë civile dhe bota akademike.

[16] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ListaOSHCKKIE.pdf

V. KONKLUZIONE DHE PLANIFIKIMI PËR VITIN 2021

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian, megjithëse në një periudhë të vështirë pandemie, do të vijojë të përmbushë detyrimin e tij ligjor, si një forum gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike,

institucioneve publike dhe shoqërisë civile. Ai do të fokusojë veprimtarinë e tij gjatë vitit 2021 në këto drejtime:

- Nxitjen e dialogut publik efiçent për zbatimin me përgjegjësi dhe cilësi të reformave integruese të ndërrmarra;
- Monitorimi dhe nxitja në forcimin e kapaciteteve të grupeve të interesit;
- Informimin korrekt të shoqërisë mbi sfidat, përfitimet dhe detyrimet në secilin prej kapitujve të legjislacionit të BE.

KKIE e konsideron komunikimin e procesit të integrimit europian të publiku dhe realizimin e gjithëpërfshirjes si sfidën kryesore përgjatë vitit në vijim. Në këtë drejtim dhe me qëllim rritjen e transparencës, KKIE do vazhdojë të transmetojë direkt takimet dhe diskutimet e mbajtura.

Nxitja dhe lehtësimi i dialogut publik mbi zbatimin dhe cilësinë e reformave si dhe informimi korrekt i shoqërisë mbi sfidat dhe përfitimet në procesin e integrimit janë vendimtare në konsolidimin e konsensusit mbarë shoqëror. Për këtë arsye do të rriten përpjekjet për bashkëbisedim me të gjithë grupet e interesit, përmes organizimit të takimeve informuese, forumeve dhe tryezave të rrumbullakëta të fokusuara në kapituj dhe politika prioritare të legjislacionit të BE, duke inkurajuar debatin konstruktiv mbi adresimin efektiv të detyrimeve të parashikuara prej tyre.

Këshilli Kombëtar, mbështetur në detyrimin ligjor, do të vijojë mbikqyrjen e ecurisë së procesit të integrimit europian dhe përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit. Një fokus të vecantë gjatë këtij viti

do ti kushtohet monitorimit të kushteve për zhvillimin e Konferencës së Parë Ndërqeveritare dhe procesit të negociatave.

Edhe gjatë vitit 2021, mbështetur në qëllimin e rikonfirmuar gjatë viteve, për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative për çështjet e integrimit europian, KKIE do të organizojë *Shkollën e Integrimit Europian*, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë. Aktualizimi i tematikave që do të trajtohen si dhe numri i përfaqësuesve që do të trajnohen, gjithnjë në përputhje me stadin që po kalon vendi, janë elementë që do rivlerësohen në organizimin e Shkollës.

ANEKS I

PROGRAMI I PUNËS

VITI 2021

Lloji i aktivitetit	Vendi	Pjesëmarrësit	Periudha
Takim mbi "*Raportimi mbi zbatimin e Planit të Veprimit për hapjen e negociatave"* dhe disktuimi dhe miratimi i Raportit vjetor 2020 të KKIE.	Tiranë	Anëtarët e KKIE, Kryenegociatori, MEPJ, MD, MB, MFE, të ftuar nga Delegacioni i BE dhe ambasadat e vendeve anëtare të BE në Shqipëri.	Janar
Takim mbi *"Sfidat në sektorin e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore, menaxhimi i ndihmës së huaj për këto fusha"*.	Tiranë	Anëtarët e KKIE, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe përfaqësues nga grupet e interesit.	Shkurt
Takim mbi "*Reformën në administratën publike, duke përfshirë edhe ecurinë mbi përgatitjen*	Tiranë	Anëtarët e KKIE, të ftuar nga Kryeministria, MEPJ, DAP, Delegacioni i BE.	Mars

Lloji i aktivitetit	Vendi	Pjesëmarrësit	Periudha
dhe sfidat e administratës publike para dhe gjatë procesit të negociatave".			
Takim ndërgjegjësues mbi procesin e Berlinit dhe ndikimi i bashkëpunimit rajonal në procesin e zgjerimit.	Tiranë	Anëtarët e KKIE, Kryeministria, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministra e Arsimit e të ftuar nga Delegacioni i BE.	Qershor
Takim mbi ecurinë në kuadër të negociatave dhe "Reformës Zgjedhore, risitë dhe sfidat e kësaj reforme".	Tiranë	Anëtarët e KKIE, Kryenegociatori, të ftuar nga MEPJ, KQZ, Delegacioni i BE, OSCE dhe ambasadat e vendeve anëtare të BE në Shqipëri.	Shtator
Takim KKIE mbi ecurinë në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, reformës në drejtësi dhe të drejtave të njeriut.	Tiranë	Anëtarët e KKIE, Kryenegociatori, të ftuar nga MEPJ, KLP, KLGJ, KED, ILD, SPAK, Delegacioni i BE, etj.	Tetor
Shkolla e Integrimit		35 – 40 pjesëmarrës nga të gjithë kategoritë e aktorëve të	

Lloji i aktivitetit	Vendi	Pjesëmarrësit	Periudha
Europian 2021.	Tiranë	përfshirë në procesin e integrimit europian të vendit.	Nëntor
Takim periodik sipas Rregullores së KKIE mbi detyrimet e negociatave të anëtarësimit në kuadër të Kapitujve: 10 "shoqëria e informacionit dhe medias", 14 "Transporti", 15 "Energjia", 21 "Rrjetet transeuropiane të transportit dhe energjisë" të acquis.	Tiranë	Anëtarët e KKIE, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të ftuar nga Delegacioni i BE dhe ambasadat e vendeve anëtare të BE në Shqipëri.	Dhjetor